



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KRYETARI
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Patos, më 10/07/2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Program i tarifave vendore”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Paketa software dhe sisteme financiare 4842000-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,221,000 (një milion e dyqind e njëzet e një mijë) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat lokale për vitin 2024.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Patos ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit.

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

Sipas percaktimeve të bera në Shtojcën 8 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/**

2.2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra vlerën e 40% të fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$$1,221,000 \times 40\% = 488,400$$

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepërmjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mësipërm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar të nevojshme përcaktimin e dy viteve të fundit në përputhje me vlerën e fondit limit të parashikuar.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenin 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.*

2.2.2 Vërtetim lëshuar per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, ne perputhje me percaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes se pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2023.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).*

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit te shlyerjes se detyrimeve vendore per vitin 2023 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e

aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohe për më shumë se një lot).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$$1,221,000 \times 20\% = 244,200$$

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe pikën 4/b të nenit 55 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e ketij kriteri behet me qellim qe Autoriteti Kontraktor te sigurohet per aftesine teknike te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet pervojës se meparshme, se zoterojne kapacitet dhe aftesine teknike per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikatë ISO 9001:2015 (ose e përditësuar) ose ekuivalent për menaxhimin e cilësisë, objekti i së cilës të ketë lidhje me objektin e prokurimit, kjo të vërtetohet me dokumentin përkatës.

ARGUMENTIM: Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi , e cila mundeson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

2.3.3. Operatori Ekonomik Ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikatë ISO 20000-1:2011 (ose e përditësuar) ose ekuivalent për menaxhimin e shërbimeve në teknologjine e informacionit, objekti i së cilës të ketë lidhje me objektin e prokurimit, kjo të vërtetohet me dokumentin përkateës.

ARGUMENTIM: Kjo certifikatë mundëson menaxhimin e cilësisë i fokusuar veçanërisht në Menaxhimin e Shërbimit IT, njëkohësisht ofron një sërë kërkesash të standardizuara për një sistem të menaxhimit të shërbimit IT (SMS).

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqese dëshmi për stafin e punonjësve të operatorit ekonomik, si dhe listëpagesat sipas formatit E-Sig, ku numri i punonjësve të siguruar të jetë jo më i vogël se 3 (tre) për periudhën nga muaji Prill dhe në vazhdim, ku përfshihet një personel teknik i diplomuar në degët si në vijim: informatike/ elektronike/ telekomunikacion/ teknologji informacioni/ informatike ekonomike/, që do të angazhohet në implementimin e projektit, me këto kompetenca:

1 (nje) punonjës të certifikuar për mbështetjen e programit sipas praktikave të ITIL ose ekuivalent

1 (një) punonjës të certifikuar për sigurinë e informacionit

1 (nje) punonjës i certifikuar si zhvillues software (software developer)

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- diplome,
- kontrata pune,
- dëshmite apo certifikatat/transkriptet përkatëse

(sqsarim: lidhur me certifikimet një punonjës mund të zotëroj më shumë se një certifikim të kërkuar për të përmbushur kriterin).

Shenim: Argumentimi i nr. te punonjeseve behet vetem me qellim per justifikimin e stafit te kerkuar. Ndaria sipas specialiteteve ne kete rubrike te mos merret ne konsiderate ne plotesimin e kriterave te percaktuara.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme në lidhje me stafin e nevojshëm për realizimin e kontratës janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e

Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të deklaroj se do të ofroj trajnim 15 ditor për përdorimin, importimin dhe agregimin e të dhënave dhe azhornimin sipas paketës fiskale 2024.

ARGUMENTIM: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 8, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.

Shënim: Duke qënë programi stoware është një program i ri dhe është hera e parë që implementohet një software i tillë në këtë institucion është e nevojshme kryerja e një trajnimi nga persona të specializuar për përdorimin dhe menaxhimin e këtij software.

Shënim: Duke qënë se këto pajisje janë specifike, profesionale dhe është hera e parë që blihen pajisje të tilla në këtë institucion është e nevojshme kryerja e një trajnimi nga persona të specializuar për përdorimin e këtyre pajisjeve.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të deklaroj së do të kryej suportin teknik dhe mirëmbajten e programit për 3 (tre) vite nga nënshkrimi i kontratës.

ARGUMENTIM: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 8, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Ky vetdeklarim kërkohet për ti vertetuar dhe garantuar AK-së realizimin me sukses të kontratës përsa i përket realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Programi special për financiar për taksat dhe tarifat vendore duhet të plotësoj specifikimet e më poshtë:

Software duhet të ofroj Menaxhim me ndërfaqe WebGIS:

- 1) Kufijve të Bashkisë
- 2) Njësi Administraive
- 3) Fshatra
- 4) Kufijtë Postare
- 5) Lagjjet
- 6) Zonat Kadastrale
- 7) Toka Bujqësore/ sipërfaqja, kategoria, pronësia, dokumenta
- 8) Toka truall/ sipërfaqja, kategoria, pronësia, dokumenta
- 9) Ndërtesa/ sipërfaqja, kategoria, pronësia, dokumenta

- 10) Infrastruktura Rrugore dhe informacion i detajuar mbi emërtimin toponimet
- 11) Asete Publike dhe informacion si:
 - Ndriçimi
 - Vendparkimet
 - Vendëdepozitimet e mbetjeve
 - Lulishte/Parqe.
- 12) Shtimi, Modifikimi i shtresave GIS të ruajtura në Database
- 13) Back UP

Menaxhimi i informacionit dhe gjenerimi automatik i raporteve për:

- 1) Gjenerimi automatik i faturave TTV (Taksa dhe Tarifa Vendore) bazuar në informacionin e mbledhur, importuar.
- 2) Opsion për Gjenerim manual i Faturave parardhëse.
- 3) Gjenerim i hartave treguese për objekte pa të dhëna
- 4) Gjenerim i hartave treguese për Taksapaguesit Debitore
- 5) Gjenerim automatik i Faturave dhe menaxhimi i Pagesave të Taksave dhe Tarifave Vendore për të gjithë Banorët (jo Biznes) nga çdo Njësi administrative.
- 6) Mundësi shtimi opsionesh për menaxhimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për Biznes, gjoba etj...
- 7) Ndërfaqe me grafikë përmbledhje e aktiviteteve të fundit Financiare Demografike etj...
- 8) Menaxhimi Online i incidenteve apo defekteve të raportuara si:
 - a) Ndriçimi
 - b) Vendparkimet
 - c) Vendëdepozitimet e mbetjeve
- 9) Paneli i Sistemit të Adresave
- 10) Paneli i Menaxhimit të dokumentacionit çdo objekt
- 11) Filtrim dhe indentifikim i të dhënave sipas attributeve të tyre
- 12) Eksporti i të dhënave në çdo kohë dhe në çdo format tabelore
- 13) Menaxhim i Përdoruesve dhe të drejtat e tyre
- 14) Shtresat GIS të jenë opsionale dhe mund të zhvillohen në varësi të kërkesave të institucionit. Të gjitha të dhënat mund të aksesohen të klasifikuara dhe të enkriptuara në kohë reale online.
- 15) Të mundësoj API për komunikim me platforma të tjera.
- 16) Funkcionim në aparate mobile.
- 17) Platforma e hostuar në Cloud të ofrohet 99.9% online
- 18) Afati i realizimit përfshirë trajnimin importimin dhe agregimin e të dhënave dhe azhurnimin sipas paketës fiskale 2024, 15 ditë në totalë.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore pranë institucionit Bashkia Patos në përputhje me objektin e prokurimit dhe nevojat e autoritetit kontraktor.

Shënim:

Referuar udhëzimeve të APP, për zërat në DST që mund të jete paraqitur marke/brand, operatorët ekonomik mund të ofertojnë ekuivalente të tyre gjatë përgatitjes së ofertës ekonomike. Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën 22.07.2024, ora 11:00.

NJËSIA E PROKURIMIT

Florian Kita

Shkëlqim Xhaferi

Çajup Refitaj